

RAPORTET E INSPEKTIMIT

Pas vizitës së inspektimit, shkruhet një raport i cili mund të publikohet në faqen tonë të internetit, www.hiqa.ie.

Ai përshkruan gjetjet e inspektimit dhe ofron një plan veprimi për ndonjë ndryshim të kërkuar, atje ku është i nevojshëm. Banorët dhe anëtarët e publikut mund të zbulojnë se cilat pjesë të shërbimit janë të mira dhe cilat pjesë duhen përmirësuar

NA KONTAKTONI

Për më shumë informacion ose për të folur me një anëtar të ekipit tonë, ju mund të na telefononi në numrin (01) 814 7400 ose na dërgoni email në adresën info@hiqa.ie. Ju mund të na shkruani edhe në adresën:

✉ **HEALTH INFORMATION
AND QUALITY AUTHORITY,
SMITHFIELD,
DUBLIN 7,
D07 E98Y.**

☎ **+353 (0)1 814 7400**

✉ **[INFO@HIQA.IE](mailto:info@hiqa.ie)**


🌐 **[WWW.HIQA.IE](http://www.hiqa.ie)**



An tÚdarás Um Fhaisnéis
agus Cáilíocht Sláinte

RRETH MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE TË AKOMODIMIT PËR TË MBROJTURIT NDËRKOMBËTARË

Albanian



RRETH HIQA

Autoriteti i informacionit dhe cilësisë së shëndetit (HIQA) është një organizatë e pavarur, e themeluar për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e shumë shërbimeve të shëndetit dhe kujdesit shoqëror në Irlandë.

Ne monitorojmë sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të tilla si spitalet, qendrat e të moshuarve dhe qendrat e kujdesit për fëmijët dhe njerëzit me aftësi të kufizuar.

Po ashtu, ne monitorojmë edhe qendrat e akomodimit të të mbrojturve ndërkombëtarë (me ofrim të drejtpërdrejtë). Kjo do të thotë se inspektorët e HIQA vizitojnë këto shërbime për t'u siguruar që ato janë të sigurta dhe plotësojnë standardet kombëtare.

STANDARDET KOMBËTARE

Me kërkesë të Ministrisë së fëmijëve, barazisë, aftësive të kufizuara, integritit dhe të rinjve, HIQA monitoron shërbimet e akomodimit që ju ofrohen personave në proces mbrojtjeje kundrejt Standardeve Kombëtare për akomodimin e ofruar për personat në proces mbrojtjeje.

Këto janë standardet kombëtare të miratuara që në vitin 2019 dhe mund të lexohen në faqen tonë të internetit www.hiqa.ie.

THÉMATIQUE DES NORMES NATIONALES

Standardet kombëtare kanë 10 tema përfshirë menaxhimin e qendrës dhe të personelit të saj, gatishmërinë për urgjenca dhe mbrojtjen e banorëve nga rreziku. Standardet vendosin gjithashtu pritshmëri për cilësinë e akomodimit të ofruar dhe kujdesjen ndaj banorëve e mbështetjen në jetët e tyre të përditshme, veçanërisht për ato persona që kanë nevojë për mbështetje specifike.

INSPEKTIMET

Ne inspektojmë akomodimin që i ofrohet personave në proces mbrojtjeje për të kontrolluar nëse ofruesi i shërbimit plotëson standardet kombëtare. Inspektimet në vend të HIQA ndihmojnë për:

- t'i dhënë zë banorëve rreth asaj çfarë do të thotë të jetosh atje
- të informuar publikun mbi cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve që ofrohen
- të nxitur përmirësimin atje ku është e nevojshme.

Inspektimet tona mund të jenë të shpallura ose jo. Ne do bëjmë çdo përpjekje për të respektuar organizimet e jetesës së banorëve dhe të minimizojmë shqetësimin e rutinës së tyre normale.

Gjatë inspektimit ne do të:

- flasim me banorët, personelin dhe drejtuesit
- mbledhim pyetësorë të plotësuar
- rishikojmë dokumentet, si p.sh. politikat
- ecim përmes ndërtesave dhe do të vëzhgojmë jetën e tyre të përditshme.

